




Pranuar / Dorezuar Primi/Prodato Received / Delivery	13.12.2022	2	viti god year
Organ / Njësia Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHKX	8020/2022		113



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

Anr. 1018/2022

Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani- kryetar, Ardita Haxhnikaj dhe Jeton Koca- anëtarë, dhe Rushit Kajtazi -Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën A. Nr. 1018/2022 të datës 17.11.2022, të parashtruar nga ankuesi tw cilin me autorizim e përfaqëson me adresë banimi rruga

kundër organit të punësimit Komuna e Gjilanit, në çështjen juridike " kompensim material", duke vepruar në pajtim duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nën paragrafin 1.1, nenin 16, nenin 18 paragrafin 1 nen paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 13.12.2022, mori këtë:

V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, shpallet jo kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A. Nr. 1018/2022 të datës 17.11.2022, të parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankues sipas shkresave të lëndës është i punësuar në Komunën e Gjilanit në pozitën Sekretar i Shkollës nëpërmjet përfaqësuesit të tij juridik avokatit me datë 17.11.2022, me numër protokollit 7191/2022, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore, lidhur me kompensimin e shpenzimeve për ushqim gjatë punës, për periudhën prill 2017, deri në dhjetor të vitit 2020.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesën A. Nr. 1018/2022 të datës 17.11.2022 e parashtruar nga ankuesit në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimi i datës 14.11.2022; Akt Emërimi i datës 29.01.2012, me numër protokolli 25; Kërkesë e datës 20.03.2020, drejtuar Drejtorisë Komunale në Komunën e Gjilanit; Përgjigje në kërkesë e datës 21.04.2020, me numër protokolli 29713; Aktvendim C. Nr. 976/2020, i datës 08.07.2021, i Gjykatës Themelore në Gjilan; Aktvendim C. Nr. 259/2020, i datës 31.10.2022, i Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative; Vërtetim i datës 25.02.2020; Vërtetim i datës 27.01.2021.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka shqyrtuar pretendimit ankimore të ankuesit lidhur me Kompensimin e shpenzimeve për ushqim gjatë punës, për periudhën nga muaj prill i vitit 2017, deri në muajin dhjetor të vitit 2020. Kolegji ka konstatuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, **nuk është kompetent** për të vendosur lidhur me ankesën e ankuesit.

Bazuar në shkresat e lëndës, kolegji, pas administrimit të provave si provë me rendësi të veçantë i ka kushtuar, Akt emërimit të datës 29.02.2012, me numër protokolli 25, me të cilin Akt Emërim ankues. mbanë pozitën Sekretar i Shkollës Fillore Mesme të Ultës "Selami Hallaqi", në Gjilan dhe mbi bazën e kësaj gjendje faktike, sa i përket pretendimit ankimor të ankuesit, lidhur me kompensimin material, për përudhin e lartcekur. Kolegji konstaton se në bazë të dispozitave ligjore në fuqi, Këshilli nuk është kompetent për ta shqyrtuar ankesën e ankuesit pasi që ankuesi nuk ka status të nëpunësit civil.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave lidhur me kompetencën e shqyrtimit të lëndës, ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrarët Publikë, neni 2 paragrafi 1 dhe 2 përcakton se: "Me këtë ligj rregullohet marrëdhënia juridike ndërmjet shtetit dhe zyrtarëve publikë. Zyrtarë publikë janë: Nëpunësi i Shërbimit Civil (në tekstin në vijim: nëpunësi civil); Nëpunësi i Shërbimit Publik; Nëpunësi i Kabinetit; dhe Nëpunësi administrativ dhe mbështetës" përkatësisht neni 2 paragrafi 4 i të njëjtit ligj ka përcaktuar se: Nëpunësi i Shërbimit Publik - është personeli i nivelit të lartë drejtues, drejtues, profesional dhe i shërbimeve të brendshme në administratën e shërbimeve publike, pjesë e administratës shtetërore apo në administratën e shërbimeve publike, pjesë e një komune të cilët ofrojnë shërbime publike të drejtpërdrejta për qytetarët në fushën e arsimit, shëndetësisë, kulturës, artit si dhe shërbime tjera të ngjashme publike", po ashtu neni 21 Ligjit Nr.04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës ku përcaktohet se " Sekretari ose administratori 1. Institucionet arsimore dhe aftësuese që kanë më shumë se pesëqind (500) nxënës kanë të drejtën të kenë sekretar ose administrator, i cili zgjidhet nga komuna përmes konkursit publik; Komuna mund të vendos të emërojë një sekretar apo administrator për institucione më të vogla përmes konkursit publik. 2. Kompetencat dhe përgjegjësit e sekretarit ose administratorit përcaktohen nga komuna në përputhje me ligjin në fuqi"

Ndërlidhur më këto dispozita rrjedhë se pozita e Sekretarit të Shkollës është pozitë e shërbimit publikë dhe marrëdhënia e tyre e punës rregullohet me Ligjin e Punës nr. 03/L-212, prandaj ngase u tha më lartë Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil shpallet jo kompetent për të vendosur lidhur me këtë



ankesë dhe pala udhëzohet që më tutje të ndjek procedurën në Gjykatën Kompetente, pasi që i njëjti i ka shterur mjetet e brendshme juridike në organin e punësimit..

Andaj, duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet që Këshilli është kompetent të shqyrtoj dhe të vendos vetëm për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në shërbimin civil, dhe duke marr parasysh se ankuesi sipas konstatimeve të dhëna me lartë nuk e ka statusin e nëpunësit civil, Kolegji i Këshillit konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.1018/2022 të datës 17.11.2022.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**LËNDA NR. A. NR.1018/2022**

**Rushit KAJTAZI**

Procesmbajtës

**Eshref SHABANI**

Kryetar i Kolegjit

**Vendimi i dërgohet:**

Avokatit

Kryetarit të Komunës së Gjilanit;

Drejtorit të Drejtorisë së Arsimit në Komunën e Gjilanit;

Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Gjilanit;

Arkivit të KPMSHCK-së